



Financuar nga
Bashkimi Evropian



FTESË Tryezë Diskutimi dhe Këshillimi

Ecuria e adresimit të rekomandimeve të Raportit të Komisionit European 2025 sa i përket fushës së sigurisë ushqimore dhe sfidat sa i përket plotësimit të angazhimeve në kuadër të procesit të negociatave në Grupkapitullin 5 “Burimet, Bujqësia, Kohezioni”/ Kapitulli 12

**E mërkurë, 4 shkurt 2026, ora 11:30
Salla e Grupeve Parlamentare (kati i IV), Kuvendi i Shqipërisë**

Këshilli Kombëtar i Integrimit Europian (KKIE) dhe Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) kanë kënaqësinë t’ju ftojnë të merrni pjesë në Tryezën e Diskutimit dhe Këshillimit, e cila zhvillohet në kuadër të dialogut ndërinstytucional dhe procesit aktual të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Kjo tryezë synon të krijojë një hapësirë gjithëpërfshirëse diskutimi dhe shkëmbimi mendimesh mes institucioneve publike, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë të interesuar, me fokus të veçantë në mbrojtjen e konsumatorit dhe sigurinë ushqimore, si fusha prioritare në kuadër të **Kapitullit 12 – Politikat e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve**. Në mënyrë të posaçme, aktiviteti vjen në funksion të diskutimit të ecurisë së përmbushjes së piketave përmbyllëse të këtij kapitulli, si dhe të gjetjeve dhe rekomandimeve të Raportit të Komisionit European për vitin 2025, duke adresuar progresin e Shqipërisë në përafrimin me *acquis* të BE-së në fushën e sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, si dhe forcimin e kapaciteteve institucionale dhe sistemeve të kontrollit zyrtar.

Gjashtë piketat e përcaktuara nga Komisioni European me hapjen e Grupkapitullit 5 – Burimet, Bujqësia dhe Kohezioni, më 17 nëntor 2025, adresojnë çështjet kryesore dhe reformat që duhet të përmbushen për mbylljen me sukses të këtij kapitulli, duke theksuar nevojën e miratimit të programeve kombëtare për modernizimin e strukturave për produktet me origjinë shtazore dhe ushqimin për kafshë, forcimit të sistemeve të kontrollit zyrtar, përfshirë HACCP-in, laboratorët dhe pikat e kontrollit kufitar, si dhe ngritjes së kapaciteteve administrative dhe infrastrukture të nevojshme për zbatimin e plotë dhe të qëndrueshëm të këtyre standardeve në momentin e anëtarësimit.

Pjesëmarrja juaj do të ishte me vlerë në diskutimin dhe shkëmbimin e mendimeve mbi ecurinë e reformave dhe sfidat aktuale në fushën e sigurisë ushqimore në kuadër të procesit të integrimit europian.

Ju lutemi, sigurohuni që të konfirmoni pjesëmarrjen tuaj paraprakisht në adresën info@em-al.org dhe të jeni të pajisur me një dokument identifikimi të vlefshëm për hyrjen në mjediset e Kuvendit.

**Kjo tryezë diskutimi dhe këshillimi zhvillohet në kuadër të projektit “Linja e gjelbër për mbrojtjen e konsumatorit – Siguria ushqimore dhe forcimi i mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve në Shqipëri nëpërmjet fuqizimit të OSHC-ve lokale”, financuar nga Bashkimi Evropian (IPA III/2024), që po zbatohet nga Qendra Alert në bashkëpunim me Lëvizjen Europiane në Shqipëri (EMA).*



Financuar nga
Bashkimi Evropian



AXHENDA

Tryezë Diskutimi dhe Këshillimi

Ecuria e adresimit të rekomandimeve të Raportit të Komisionit European 2025 sa i përket fushës së sigurisë ushqimore dhe sfidat sa i përket plotësimit të angazhimeve në kuadër të procesit të negociatave në Grupkapitullin 5 “Burimet, Bujqësia, Kohezioni”/ Kapitulli 12

E mërkurë, 4 shkurt 2026, ora 11:30
Salla e Grupeve Parlamentare (kati i IV), Kuvendi i Shqipërisë

11:30 – 11:50

Hapja e takimit dhe fjala e mirëseardhjes

- Z. Taulant Balla, Bashkëkryetar, Këshilli Kombëtar i Integritimit European
- Z. Gledis Gjipali, Drejtor Ekzekutiv, Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)

11:50 – 12:20

Ecuria e adresimit të rekomandimeve të Raportit të Komisionit European 2025 sa i përket fushës së sigurisë ushqimore dhe plotësimit të angazhimeve në kuadër të procesit të negociatave në Grupkapitullin 5 “Burimet, Bujqësia, Kohezioni”/ Kapitulli 12

- Z. Andis Salla, Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

12:20 – 13:00

Diskutim i hapur

13:00

Mbyllja e takimit

**Kjo tryezë diskutimi dhe këshillimi zhvillohet në kuadër të projektit “Linja e gjelbër për mbrojtjen e konsumatorit – Siguria ushqimore dhe forcimi i mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve në Shqipëri nëpërmjet fuqizimit të OSHC-ve lokale”, financuar nga Bashkimi Evropian (IPA III/2024), që po zbatohet nga Qendra Alert në bashkëpunim me Lëvizjen Europiane në Shqipëri (EMA).*